



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Pml.nr.33/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Afrim Shala, kryetar i kolegjit, Rasim Rasimi dhe Agim Maliqi anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të dënuarit S. M., për shkak të veprave penale vjedhja e rëndë nga neni 315 paragrafi 2 nën paragrafi 2.1 lidhur me nenin 313 paragrafi 1 dhe veprës penale vjedhja nga neni 313 paragrafi 1 të KPRK, duke vendosur sipas kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të dënuarit të paraqitur kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Pejë-Dega në Istog P.nr.136/20 të datës 14.02.2023 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti i Përgjithshëm PN.nr.662/2023, të datës 23.08.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 23.01.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të dënuarit S. M., e paraqitur kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Pejë-Dega në Istog P.nr.136/20 të datës 14.02.2023 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti i Përgjithshëm PN.nr.662/2023, të datës 23.08.2023.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Pejë- Dega në Istog me aktgjykimin P.nr.136/20 të datës 14.02.2023, të dënuarin S. M. e ka shpall fajtor për veprën penale vjedhja e rëndë nga neni 315 paragrafi 2 nën paragrafi 2.1 lidhur me nenin 313 paragrafi 1 të KPRK dhe veprën penale vjedhja nga neni 313 paragrafi 1 të KPRK, dhe për veprën penale nën I të dispozitivit i ka shqiptuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tri) vite, kurse për veprën penale nën II të dispozitivit dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve. Me aplikimin e dispozitës së nenit 76 të KPRK, e ka gjykuar me dënim unik burgimi në kohëzgjatje prej 3 (tre) vite e 3 (tre) muaj dhe me dënim me gjobë në shumë prej 200 (dyqind) €.

Të dënuarin F.B., e ka shpall fajtor për veprën penale blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale nga neni 333 paragrafi 1 lidhur me paragrafin 3 të KPRK dhe i ka shqiptuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve, i cili dënim me

pëlqimin e të dënuarit konform nenit 44 të KPRK, i zëvendësohet me dënim me gjobë në shumë prej 300 (treqind) €, të cilën është i obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Nëse i dënuari nuk mund ose nuk dëshiron ta paguajë dënimin me gjobë brenda afatit të lartcekur, gjykata do tia zëvendësojë me dënim me burgim duke ia llogaritur për çdo 20 € të gjobës me një ditë burgim.

Janë obliguar të dënuarit që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguajnë paushallin gjyqësor në shumë prej 20 €, ndërsa në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit të paguajnë secili veç e veç shumën prej 30 €.

Gjykata Themelore në Pejë-Dega në Istog me aktvendimin P.nr.136/20 të datës 10.05.2023, e ka hedhur si të palejuar ankesën e mbrojtësit të dënuarit të paraqitur kundër aktgjykimit të kësaj gjykate P.nr.136/20 të datës 14.02.2023.

Në procedurën ankimore Gjykata e Apelit e Kosovës – Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin PN.nr.662/2023 e datës 23.08.2023, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të dënuarit, ndërsa aktvendimin e shkallës së parë P.136/20 të datës 10.05.2023 e ka vërtetuar.

Kundër aktgjykimit të shkallës së parë dhe kundër aktvendimit të gjykatës së shkallë së dytë, kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur:

-mbrojtësi i të dënuarit S. M., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që kërkesa të aprovohet si e bazuar kurse aktgjykimi i shkallës së parë të anulohet dhe çështja të kthehet në rivendosje.

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit të Kosovës, me shkresën KMLP.II.nr.15/2024 e datës 19.01.2024, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të dënuarit të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit pasi i shqyrtoi shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të KPPK-së dhe pasi i vlerësoi pretendimet nga kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, konstatoi se:

- kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e pabazuar.

Mbrojtësi i të dënuarit në kërkesë, pretendon se dy aktgjykimet e gjykatave janë marrë me shkelje të ligjit penal dhe me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale. Pretendohet në kërkesë se gjykata e shkallës së parë nuk e ka marrë për bazë pranimin e fajësisë, apo e ka nën vlerësua pranimin e fajësisë, pendimin e thellë dhe kërkim faljen e të dënuarit, nuk e ka marrë parasysh edhe rrethanën se të dënuarit tashmë gati i ka lind bashkëshortja.

Gjykata Supreme e Kosovës, konstaton se pretendimet e mbrojtësit të dënuarit janë të pabazuara, për faktin se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe aktvendimi i gjykatës së shkallës së dytë nuk janë të përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale e as me shkelje të ligjit penal, pasi që janë dhënë arsyet dhe janë paraqitur drejtë dhe qartë arsyet për faktet vendimtare që kanë të bëjnë lidhur me shqiptimin e sanksionit penal.

Duke vlerësuar pretendimet e mbrojtësit të dënuarit, Gjykata Supreme e Kosovës e sheh të nevojshme fillimisht të theksoj faktin se i dënuari në shqyrtimin gjyqësor e ka bërë pranimin e fajësisë dhe si rezultat i konstatimit të gjykatës se janë përmbushur kriteret e përcaktuara, pranimi i fajësisë ishte aprovuar. Me këtë rast duhet theksuar fakti se pranimi i fajësisë në asnjë rrethanë nuk prejudikon caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, por e rëndësishme është që i dënuari ka qenë i njoftuar përkitazi me veprën penale, natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, ndërsa i njëjti e ka pranuar fajësinë dhe atë në prezencë të mbrojtësit të tij.

Siç është theksuar edhe më parë, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është paraqitur për shkak të shkeljes së ligjit penal lidhur me dënimin e shqiptuar, përkatësisht faktin se me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, të dënuarit i është shqiptuar dënim i lartë. Në lidhje me këto pretendime, Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se në mënyrë të drejtë është zbatuar ligji penal dhe të dënuarit i është shqiptuar dënimi i përcaktuar në suaza të dispozitës së lartcekur për veprat penale për të cilat i dënuari është shpall fajtor.

Në arsyetimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë janë theksuar të gjitha rrethanat që kanë ndikuar në shqiptimin e llojit dhe lartësisë së dënimit. Përndryshe, duhet theksuar faktin se nuk është në kompetencë të Gjykatës Supreme të Kosovës shqyrtimi i lartësisë së dënimeve të shqiptuara, por e rëndësishme është se me rastin e shqiptimit të dënimit nuk janë tejkualuar kompetencat ligjore, kështu që pretendimet e mbrojtësit në këtë drejtim nuk qëndrojnë.

Megjithatë, bazuar në dispozitën e nenit 385, paragrafi 5. të KPP, kur është fjala për vendimin për dënim, shkelje e ligjit penal bëhet vetëm në rastet kur gjykata i ka tejkualuar kompetencat ligjore me rastin e shqiptimit të dënimit, ndërsa në rastin konkret nuk ka ndodhur një gjë e tillë.

Në rast se nuk është fjala për këtë shkelje, vendimi për dënimin me këtë mjet të jashtëzakonshëm juridik, mund të kundërshtohet vetëm nëse kjo pjesë e aktgjykimit është marr me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale e cila do të mund të ndërli dhej me mungesën ose paqartësitë e arsyeve lidhur me vendimin për dënimin, mirëpo, në rastin konkret një pretendim i këtillë në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk është paraqitur.

Nga arsyet e cekura më lartë, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, është refuzuar si e pabazuar dhe në pajtim me dispozitën e nenit 437 të KPPK është vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.33/2024, më datë 23.01.2023

Procesmbajtës,
Bujar Balaj

Kryetari i kolegjit,
Afrim Shala